



UNIVERSITETI I EVROPËS LIGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE
CIKLI I DYTË I STUDIMEVE

IMPLEMENTIMI I DATA WAREHOUSE – RAST STUDIMI NË KOMPANINË KEDS

KANDIDATI:
Bsc. NERTILA KRYEZIU

Tetovë, Maj, 2019

MENTORI:
Assoc. Prof. Dr. FLORIJE ISMAILI

Deklaratë

Deklaroj se kjo tezë dhe puna e raportuar këtu, ka përbërje tërësisht origjinale. Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve.

Tetovë,
Maj/2019

Falënderim

Pjesa praktike e këtij punimi të magistraturës është zhvilluar në departamentin e IT-së në kompaninë KEDS. I falënderoj drejtorin e departamentit dhe kolegët të cilët më ndihmuan në realizimin e këtij projekti.

Falënderim të veçantë për familjen time të cilët më kanë përkrahur në të gjitha fazat e ngritjes time akademike. Ky rrugëtim nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e tyre.

Faleminderit!

Nertila Kryeziu

Abstrakt

Në botën e biznesit, shumë kompani të mëdha i organizojnë dhe i mirëmbajnë të dhënat e tyre në baza të mëdha të të dhënave. Me kalimin e viteve sasi e madhe e të dhënave do të grumbullohen në sistemin e kompanisë, me rritjen e shpejtë të sistemit ndodhin edhe problemet për krahasimin dhe analizimin e të dhënave. Kompanitë duhet të analizojnë saktë të dhënat e grumbulluara dhe në bazë të tyre të kryejnë disa funksione thelbësore për kompaninë të tilla si planifikimi, parashikimi dhe menaxhimi. Vështirësitë e përmendura më lart kanë detyruar ekspertët e teknologjisë të gjejnë zgjidhje të reja për të ndihmuar njerëzit që marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes dhe iu mungojnë njohuritë teknike. Në vitet e fundit, koncepti i data warehouse ka filluar të shfaqet si një lloj i ri i sistemeve komplekse të mbështetjes së vendimeve.

Data warehouse mund të definohet thjeshtë si një grup i të dhënave që mbështetë përdoruesit në marrjen e vendimeve strategjike. Këto të dhëna janë të organizuara në atë mënyrë që do të paraqesin përdorim të lehtë dhe performancë të shkëlqyeshme të raportimit.

Tema e këtij studimi është të hartojë dhe të zhvillojë një data warehouse duke përdorur bazat e të dhënave të kompanisë. Së pari përcaktohen hapat e zhvillimit të data warehouse dhe më pas aplikohet pjesa shpjeguese e funksionimit të saj. Implementimi i data warehouse, që përbën subjektin e kësaj teze, kryhet në një kompani në sektorin e energjisë.

Kjo tezë do të paraqesë përfitimin në kohë dhe efikasitetin e raportimit me përdorimin e data warehouse.

Fjalori

Fjala kyçe	Përshkrimi
EDW	Enterprise Data Warehouse – data warehouse në ndërmarrje
Data warehouse	‘Depo’ e të dhënave, përmbledhë të dhëna nga sisteme të ndryshme.
ETL	Ekstraktim, Transformim dhe Ngarkim i të dhënave nga bazat e të dhënave transaksionale në data warehouse.
SSIS	SQL Server Integration Services.
SSRS	SQL Server Reporting Services.
SSAS	SQL Server Analysis Services.
KPI	Indikatori kyç i performancës
DSV	Data Source View

Përmbajtja

	DEKLARATË.....	II
	FALËNDERIM.....	III
	ABSTRAKT	IV
	FJALORI.....	V
	LISTA E FIGURAVE.....	VIII
1	HYRJE.....	10
	1.1 NDËRLIKIMET	10
	1.2 SHPJEGIMI	11
	1.3 MOTIVIMI	11
	1.4 EKSPERIENCA.....	12
	1.5 DOKUMENTACIONI.....	13
2	DATA WAREHOUSEING.....	18
	2.1 ÇKA ËSHTË DATA WAREHOUSE?	18
	2.2 QËLLIMET E DATA WAREHOUSE.....	19
	2.3 APLIKIMI I DATA WAREHOUSE NËPËR KOMPANI	20
	2.4 ELEMENTET BAZIKE TË DATA WAREHOUSE.....	21
	2.4.1 Sistemi burimor.....	21
	2.4.2 Hapësira e paraqitjes së të dhënave.....	21
	2.4.3 Serveri prezentues	21
	2.4.4 OLAP (On-Line Analytic Processing – Procesimi analitik).....	21
	2.4.5 Aplikacionet për shfrytëzuesit fundorë	22
	2.4.6 Aplikacionet modeluese	22
	2.5 PËRFITTIMET E APLIKIMIT TË DATA WAREHOUSE.....	22
	2.6 FAKTORËT KRYESORË QË MIRREN PARASYSH GJATË DIZAJNIMIT TË DATA WAREHOUSE	23
3	ARKITEKTURA E SISTEMIT	25
	3.1 MODELI DIMENZIONAL	25
	3.2 SHITRESAT E DATA WAREHOUSE	26
	3.3 METADATA	27
	3.4 TREGU I TË DHËNAVE (DATA MARTS).....	28
	3.4.1 Çka është tregu i të dhënave.....	28
	3.5 SHITIGJET E ZHVILLIMIT TË TREGUT TË TË DHËNAVE.....	29
	3.5.1 Shtegu Lart-Poshtë.....	29
	3.5.2 Shtegu Poshtë-Lart.....	30
	3.5.3 Shtegu i Federuar.....	31
	3.6 DALLIMET NDËRMJET DATA WAREHOUSE DHE TREGUT E TË DHËNAVE	
	32	
	3.7 SKEMA YLL.....	33
	3.8 SKEMA SNOWFLAKE	33
	3.9 MBUSHJA DHE PROCESI ETL.....	34

3.10	ALTERNATIVA ETL.....	37
3.11	BIZNIS INTELIGJENCA	38
3.12	RAPORTIMI.....	38
3.13	IMPLEMENTIMI.....	41
3.14	PROTOTIPI I DATA WAREHOUSE SË NDËRMARRJES	41
3.15	KONSTRUKTIMI I ETL.....	42
3.16	MBUSHJA E TABELAVE	43
3.16.1	<i>Mbushja e tabelave dimenzion</i>	43
3.16.2	<i>Mbushja e tabelave fakt</i>	48
3.17	KONSTRUKTIMI I KUBEVE	53
3.17.1	<i>Krijimi i DSV</i>	53
3.17.2	<i>Krijimi i kubit</i>	53
3.17.3	<i>Definimi i kalkulimeve</i>	54
3.17.4	<i>Definimi i KPI</i>	55
3.17.5	<i>Definimi i aksioneve</i>	55
3.18	RAPORTET.....	56
3.18.1	<i>Faturimi i kWh dhe numri i konsumatorëve</i>	56
3.18.2	<i>Faturimi TS</i>	58
3.18.3	<i>Pagesat</i>	59
3.18.4	<i>Raporti i faturave zero</i>	60
4	VLERËSIMI I PERFORMANCËS	61
4.1	PARAQITJA E PËRGJITHSHME.....	61
4.2	PLANI TESTUES.....	61
4.2.1	<i>Faturimi i kWh dhe numri i konsumatorëve</i>	62
4.2.2	<i>Faturimi i TS</i>	63
4.2.3	<i>Pagesat</i>	65
4.2.4	<i>Raporti i faturave zero</i>	66
5	KONKLZIONI	69
	BIBLIOGRAFIA	71

Lista e Figurave

Figura 1. Data warehouse në ndërmarrje	14
Figura 2. Elementet bazë të data warehouse	28
Figura 3. Arkitektura informative e ndërmarrjes.....	29
Figura 4. Shtegu lart - poshtë.....	30
Figura 5. Shtegu poshtë – lart.....	31
Figura 6. Shtegu i federuar	32
Figura 7. Diagrami i bazës së të dhënave të data warehouse.....	43
Figura 8. Control Flow i tabelës dimension 'AccountCode'	44
Figura 9. Data Flow i tabelës dimension 'AccountCode'.....	44
Figura 10. Control Flow i tabelës dimension 'ElDebitors'	45
Figura 11. Data Flow i tabelës dimension 'ElDebitors'	46
Figura 12. Control Flow i tabelës dimension 'PostGLArchive'.....	47
Figura 13. Data Flow i tabelës dimension 'PostGLArchive'	47
Figura 14. Control Flow i tabelës dimension 'Readers'.....	48
Figura 15. Data Flow i tabelës dimension 'Readers'.....	48
Figura 16. Control Flow i tabelës fakt 'Invoices'.....	49
Figura 17. Data Flow i tabelës fakt 'Invoices'.....	49
Figura 18. Control Flow i tabelës fakt 'HPIInvoices'.....	50
Figura 19. Data Flow i tabelës fakt 'HPIInvoices'.....	50
Figura 20. Control Flow i tabelës fakt 'GLArchive'.....	51
Figura 21. Data Flow i tabelës fakt 'GLArchive'.....	51
Figura 22. Control Flow i tabelës fakt 'DOCorrections'.....	52
Figura 23. Data Flow i tabelës fakt 'DOCorrections'.....	52
Figura 24. Krijimi i DSV.....	53
Figura 25. Krijimi i kubit	54
Figura 26. Lidhja e dimensioneve me grupet matëse	54
Figura 27. Kalkulimi	55
Figura 28. Krijimi i KPI.....	55
Figura 29. Krijimi i aksionit ‘drillthrough’.....	56
Figura 30. Faturimi kWh në SSRS.....	58
Figura 31. Raporti i faturimit TS në SSRS	59
Figura 32. Raporti i pagesave në SSRS	60
Figura 33. Raporti i faturave zero në SSRS.....	60
Figura 34. Faturimi kWh në bazën e të dhënave transaksionale.....	62
Figura 35. Faturimi kWh në datawarehouse	63

Figura 36. Rezultatet grafike të faturimit kWh	63
Figura 37. Faturimi TS në bazën e të dhënave transaksionale	64
Figura 38. Faturimi i TS në data warehouse	64
Figura 39. Diagrami i krahasimit të faturimit të TS	65
Figura 40. Pagesat në bazën e të dhënave transaksionale	65
Figura 41. Pagesat në data warehouse	66
Figura 42. Diagrami i rezultateve të pagesave	66
Figura 43. Raporti i zerove në bazën e të dhënave transaksionale	67
Figura 44. Raporti i zerove në data warehouse	67
Figura 45. Diagrami i rezultateve të zerove	68

Kapitulli I

1 Hyrje

1.1 Ndërlikimet

Implementimi i Data Warehouse në kompani, në rastin tonë në kompaninë KEDS, duket se do të zgjidhë problemin e integritit të shumë sistemeve në një burim të përbashkët të të dhënave. Llojet e shënimeve që ka kompania, të dhënat për konsumatorët, punëtorët, faturat, etj., janë të regjistruara në baza të ndryshme të të dhënave. Duke i pasur parasysh këto ndarje, ka të dhëna të cilat janë në interes të më shumë departamenteve mirëpo në to ka qasje vetëm një departament. Të paturit e një data warehouse që i ndanë këto shënime ndërmjet departamenteve do të mund të shkaktoj shkelje të sigurisë. Prandaj, hartimi i një plani për kufizim të qasjeve në të dhëna, është më se i arsyeshëm.

Problemi kryesor i mos pasjes së data warehouse në kompani është konsumimi i të dhënave nga shfrytëzuesit prej formës së raporteve aktuale. Shumë shpesh ata që kanë nevojë për informacion ose kërkojnë informata nga të dhënat që ata i shfrytëzojnë, duhet të presin raportin bazuar në kohën e dikujt tjetër. Atyre iu duhet të manipulojnë me të dhënat të cilat i marrin dhe mundësia e gabimit është më e madhe.

Zhvillimi i teknologjisë kohët e fundit ndihmon shumë në zvogëlimin e gabimeve dhe kompanitë e mëdha duhet të kenë raporte sa më të sakta. Në vend se drejtuesit e kompanisë apo menaxherët të presin marrjen e raporteve nga departamentet përkatëse, atyre duhet t'i u mundësohet të nxjerrin informatat që iu nevojiten në çfarë do kohe dhe pa u varur nga departamentet tjera.

1.2 Shpjegimi

Përdorimi i informatave që ofron data warehouse për marrjen e vendimeve të ndryshme janë komponentë e rëndësishme e biznes inteligjencës. Data warehouse përdoret jo vetëm për të marrë të dhëna, por edhe për t'i paraqitur ato tek shfrytëzuesit që të mund t'iu qasen në formatin e tyre të dëshiruar.

Për shfrytëzuesit të cilët dëshirojnë të marrin të dhënat vetë, pa pritur shpërndarje nga të tjerët ka shumë vegla për raportim të cilat janë në dispozicion dhe të cilat bëjnë që data warehouse të jetë më lehtë të përdorshme.

1.3 Motivimi

Në implementimin e data warehouse në kompani kontribuojnë shumë faktorë. Edhe pse zbatimi i një projekti të tillë mund të kërkojë shumë kohë, burime dhe investime monetare nga ana e kompanisë, ka shumë faktorë motivues për të ecur përpara në zbatimin e këtij projekti.

Motivimi më i rëndësishëm në implementimin e data warehouse është që të kemi një platformë më të përshtatshme për raportim. Duke i kombinuar të gjitha bazat e të dhënave të kompanisë, data warehouse do të jetë burim i vetëm për marrjen e të dhënave nga shfrytëzuesit.

Me përdorimin e data warehouse, përpiluesi i raporteve nuk ka nevojë t'i mësojë të gjitha bazat e të dhënave apo të mundohet t'i lidhë të dhënat ndërmjet tyre, pasi që kjo është një punë shumë e vështirë.

Përveç që kemi një bazë të vetme të të dhënave, kemi edhe shumë përparësi tjera në mos raportimin nga bazat e të dhënave transaksionale. Raportimi nga baza e të dhënave transaksionale mund të ngadalësojë performancën e bazës së të dhënave. Gjatë përpilimit të raportit të dhënat mund të jenë në proces të modifikimit apo fshirjes, të cilat do të bënin raportin jo korrekt.

Një përparësi tjetër e kompletimit të raporteve nga data warehouse është fakti se mund të ketë një vegël të vetme për raportim dhe shpërndarje së raporteve për të gjithë shfrytëzuesit. Përparësia e kësaj lloji vegle do të ishte siguri i shpërndarjes në kohë, menaxhimi i të dhënave si dhe mundësia e ruajtjes së gjurmëve të auditimit të të dhënave.

Nga pikëpamja e departamentit të Teknologjisë Informative, data warehouse do të lehtësojë punën e kontrollit të sigurisë. Në vend se të kontrollojmë sigurinë

në çdo bazë të të dhënave dhe për çdo shfrytëzues, në data warehouse do të kemi vetëm një bazë të të dhënave ku do të menaxhojmë shfrytëzuesit dhe të drejtat e tyre. Për më tepër, IT do të ketë nën kontrollë dhe menaxhim të dhënat e kompanisë të cilat shfrytëzuesit pastaj mund t'iu qasen për të përmbushur nevojat e tyre.

Ndoshta, një prej arsyeve më të nënvlerësuara të data warehouse është fakti se ajo mund të përmbajë të dhëna historike. Një bazë e të dhënave transaksionale nuk përmbanë të dhëna historike sikurse data warehouse sepse shfrytëzuesi shumë herë modifikon apo fshinë këto të dhëna përgjatë ditës.

Arsyeja kryesore për zhvillimin e data warehouse për kompani (Enterprise Data Warehouse) është se ekziston një model i arsyeshëm i të dhënave i zhvilluar për shfrytëzuesit ashtu që qëndrueshmëria është çelësi kryesor për konsumimin e të dhënave në të gjithë kompaninë. Pavarësisht nga burimi i të dhënave, modeli i të dhënave i jep shfrytëzuesit një mënyrë të përbashkët për të marrë të dhënat që ata dëshirojnë për të përmbushur qëllimet e tyre.

Tani më shumë se kurrë më parë, kompanitë mbështeten në informata të sakta, të sigurta dhe të përditësuara në raportet e tyre për të ndihmuar operacionet e kompanisë së tyre. Duke pasur një burim të përbashkët të të dhënave për shfrytëzuesit dhe duke larguar barrën e raportimit direkt nga bazat e të dhënave transaksionale mund të përmirësohet efikasiteti dhe ndarja e të dhënave në të gjithë kompaninë.

Zgjidhja e data warehouse zëvendëson Excel-in dhe platformat tjera raportuese me zgjidhje moderne dhe të centralizuara të raportimit dhe analizës. Aftësia për të konsoliduar të gjitha të dhënat e rëndësishme dhe të lidhura për një verzion të vetëm të së vërtetës është themelore për raportimin e saktësisë.

1.4 Eksperienca

Unë do të paraqes një shembull real të bartjes së raportimit prej bazës së të dhënave transaksionale në data warehouse. Ky shembull krahason diferencën ndërmjet ekzekutimit të pyetësorit të njejtë në tabela në bazën e të dhënave transaksionale kundrejt pyetësorit me të dhëna të grupuara në skemën yll që përmbajnë të dhënat e njejta.

Duke përodrur një sërë masash në kohën e duhur, avantazhet e raportimit nga data warehouse do të jenë më të qarta. Krahasimet do të tregojnë për dallimet

në kohë për pyetësorë të ndryshëm, të cilët do të kthejnë të përmirësuar kohën e përgjithshme të raportimit nga shfrytëzuesit. Ka avantazhe dhe disavantazhe për secilin, por në përgjithësi, do të jetë shumë e dobishme raportimi nga data warehouse. Një nga përparësitë kryesore të implementimit të EDW është për të përmirësuar kohën e raportimit dhe të prezantohen të dhënat në mënyrë që shfrytëzuesit mund t'i shfrytëzojnë ato për të bërë vlerësime më të mira dhe të përmirësojnë efikasitetin brenda departamentit të tyre.

1.5 Dokumentacioni

Qëllimi i këtij punimi është të tregohen përparësitë e implementimit të EDW në kompani. Me EDW ne kemi mundësi t'i integrojmë të dhënat nga shumë baza të të dhënave të cilat shfrytëzohen nga aplikacione të ndryshme nga departamentet e kompanisë. Me gjithë këto informata të përhapura në të gjithë kompaninë, duke përfshirë edhe mundësinë që një person mund të ketë qasje në më shumë se një sistem, të kemi vetëm një burim të të dhënave është një arsye e rëndësishme për implementimin e EDW. Departamentet raportojnë vetëm brenda njësie të tyre, kështu që ka mundësi që mos të bëhet shkëmbimi i informacioneve në mënyrë adekuate nëpër kompani. Edhe në qoftë se informacioni tashmë është shpërndarë, shumë përdorues do të shkëmbejnë materiale përmes e-mailit apo ndonjë forme tjetër që nuk është edhe aq e përshtatshme dhe mund të dështojnë në ndarjen e materialit në mënyrë të arsyeshme dhe të sigurtë. Duke i pasur të dhënat në një burim të vetëm dhe të menaxhuara mirë nga departamenti i IT-së, të dhënat janë në dispozicion për shfrytëzuesit në një platformë të vetme dhe të gatshme për ata që kanë nevojë t'i marrin këto informata.

Kompania ka shumë departamente dhe në secilin prej tyre kemi aplikacione të cilat kanë baza të të dhënave që i ruajnë të gjitha informatat e përdorura nga aplikacioni. Bazat e të dhënave dhe aplikacionet mund të jenë të mëdha apo të vogla, mirëpo secila prej tyre do të ketë vend në EDW për të përmbushur nevojat e shërbimeve të raportimit brenda kompanisë.

Gjatë shqyrtimit të nevojave për EDW është e rëndësishme të shikohen të gjitha departamentet dhe të shikohet se çka kanë mundësi ata të ndihmojnë në këtë projekt.




Figura 1. Data warehouse në ndërmarrje

Me krijimin e EDW mund të lindin pyetje të ndryshme se çfarë përfitimi do të kemi nëse i kemi të dhënat të mbledhura në një vend, veçanërisht nëse kompania funksionon mirë edhe në atë mënyrë. Ideja e EDW do të jetë ofrimi i raportimit më të lehtë dhe qasja më e shpejtë në informata.

Duke i pasur të dhënat nga baza të të dhënave të ndryshme në një raport, çon në përhapje më të mirë të informatës dhe zvogëlon mundësinë e implikimeve të performancës.

Për implementimin e EDW nuk ka justifikim më të madh se mundësia e konsumimit dhe raportimit të të dhënave në mënyrë më të mirë dhe më të shpejtë se forma aktuale në të cilën janë mësuar të punojnë përdoruesit. Me veglat e raportimit të cilat janë në dispozicion tani, mund të mendohet se gjërat nuk mund të jenë më mirë se që janë tani. Megjithatë, siç e kemi shqyrtuar implementimin e data warehouse, do të gjejmë se ka zgjidhje më të mira për raportim. Më tej, siç i kemi analizuar ne, do të ketë përmirësim të dukshëm të infrastrukturës së data warehouse.

Me mundësitë e mëdha që kompanisë i ofron EDW, është e rëndësishme të kujtojmë se për të ndërmarrë një përpjekje të tillë kërkohet një grup i caktuar njerëzish brenda kompanisë që nevojiten për krijimin e sistemit. Këtu përfshihet një përkrahës i fuqishëm ekzekutiv që do të jetë udhëheqës, një arsye solide e kompanisë që ofron motivimin, dhe në fund një projekt i organizuar i cili duhet

të ketë një lider menaxhmenti. Çdo pjesë e këtij koordinimi për të zhvilluar data warehouse është më sfiduese se zhvillimi fizik i vetë data warehouse, pasi motivimi dhe përkrahja financiare është më se e nevojshme.

Një nga pjesët më të rëndësishme të implementimit të EDW është se duhet të ketë një përkrahës të fuqishëm ekzekutiv që do ta përkrahë përpjekjen për kalim në data warehouse. Përkrahësit ekzekutiv definojnë si: “përkrahës të fuqishëm të biznesit të cilët kanë influencë të madhe në kompani” [1].

Gjithashtu i rëndësishëm është edhe virtyti i udhëheqësit, i cili është jetik për udhëheqjen e të tjerëve drejt hapave të ndryshëm të zhvillimit të data warehouse. Për më tepër, ”përkrahësit efektiv janë në gjendje të mirren me problemet dhe pengesat afat-shkurtëra për shkak se ata janë të fokusuar në suksesin afatgjatë të projektit“ [1]

”Kompanitë të cilat i implementojnë me sukses zgjidhjet DW/BI, në mënyrë tipike kanë një sens të fuqishëm të urgjencës për përmirësimin e qasjes në informata të shkaktuara nga motivet bindëse të biznesit“ [1].

Kompanitë mund të jenë të suksesshme me metodat e tyre aktuale për nxjerrjen e informatave, mirëpo ka gjithmonë vend për përmirësim dhe dëshirë për kursim në kohë dhe rezultate më të shpejta të cilat i ofron implementimi i data warehouse.

“Sistemet DW/BI që lidhen me motivimet dhe iniciativat strategjike të biznesit janë një shansë e mirë e suksesit“. [1] Kjo është një arsye për të besuar se nëse një proces i përmirësuar i raportimit do t’i plotësojë më mirë nevojat e biznesit, atëherë implementimi i data warehouse do të bëhet prioritet.

Përderisa kemi mbështetjen e përkrahësve të kompanisë për të krijuar EDW, atëherë i mbetet departamentit të IT-së të ofroj zgjidhje për implementimin e data warehouse. IT-së i mbetet të trajtojë stafin dhe të mbikëqyr projektin deri në kompletimin e saj. Drejtuesit të projektit i duhet të udhëheqë stafin e dy grupeve, atë të IT-së dhe departamenteve tjera.

Ekipi i projektit do të përbëhet nga ata që kuptojnë se si implementohet një projekt i tillë apo do të kenë një bazë kontraktuese për të ndihmuar në zhvillimin e data warehouse. Fakti se “Është e zakonshme për ekipin e DW/BI të merr pjesë në detyrat e zhvillimit dhe operimit me të dhëna duke pasur parasysh natyrën përsëritëse të ciklit të zhvillimit të projektit DW/BI“ [1], tregon se ekipi i

projektit është i përbërë më shumë nga staf teknik por edhe përkrahës të cilët do t'i ndihmonin në edukimin e përdoruesve. Ata do t'i ndajnë njohuritë e tyre përmes diskutimeve të hapura apo mbledhjeve të organizuara.

Pas takimit të parë rreth projektit të përbërë nga të gjithë përdoruesit dhe udhëheqësit, ekzekutivi i projektit fillon me planin e projektit dhe grumbullimin e kërkesave. Kërkesat për data warehouse mund të duken të qarta sipas shpjegimit të deritashëm, mirëpo në këtë fazë ka vend për të dhëna nga të gjithë të përfshirët në projekt. Këto të dhëna mund të grumbullohen përmes diskutimeve në të cilat përmbledhen nevojat e të gjithëve rreth këtij projekti. Ralph Kimball thekson se në këtë fazë nuk është e nevojshme vetëm të dihet se çka dëshirojnë të tjerët nga data warehouse, por më shumë të mësohet se si lidhet ajo me punën e tyre. Ai thotë se "Ju duhet të flisni me ta rreth punës, objektivave dhe sfidave të tyre" [1]. Kjo tashmë ka kuptim pasi data warehouse do të përfitojë më mirë komunitetin nëse ua bënë punën më të lehtë dhe u ofron zgjidhje për disa nga punët e tyre që janë më të vështira. Pas përfundimit të kësaj serie të grumbullimit të informatave, plani i projektit vazhdon me vendosjen e qëllimeve se si do të përfundojë projekti nëpër fazat e nevojshme për të qenë i suksesshëm. "Koordinimi i përkrahjes, administrimit dhe praktikave më të mira në nivel të programit janë vendimtare për të rritur kthimin potencial të biznesit nga investimi i juaj në DW/BI" [1].

Për bartjen e të dhënave nga një burim në tjetrin nevojitet një hap tjetër i rëndësishëm para se të bëhet kjo bartje, dhe kjo duhet të jetë si projekt i veçantë në nivel departamenti, e jo si pjesë e implementimit të data warehouse.

Ekzistojnë shumë hapa dhe procedura të nevojshme për t'u ndjekur gjatë bartjes së të dhënave në data warehouse, të cilat zakonisht janë më të lehta të ndiqen në fazat e hershme të zhvillimit.

Gjatë bartjes së të dhënave duhet të ekzistoj një standard i cili do të sigurojë të dhëna më të sigurta. Duke pasur një plan të standardizimit para futjes së të dhënave në vend se t'i pastrojmë ato më vonë, do të jetë një zgjidhje më e mirë, në këtë rast do të bëhet ndryshimi i sjelljes së njerëzve në vend të sistemit. Standardizimi do të nevojitet edhe gjatë fazës së zhvillimit të ETL.

Para se të fillohet procesi i konstruktimit të EDW, kemi shumë pjesë të rëndësishme të projektit që paraqesin sfondin e data warehouse dhe do të çojnë në implementimin e suksesshëm të këtij projekti.

Pjesa më e rëndësishme e projektit është rezultati përfundimtar i data warehouse ku shihet se si e gjithë përmbajtja e departamenteve vjen e bashkuar për t'iu dhënë mundësinë përdoruesve të raportojnë një pasqyrë të madhe.

Para se të filloj përdorimi i data warehouse, është e nevojshme që lideri të përkrahë data warehouse dhe të përhapë vizionin e projektit te ekipet e përdoruesve që do të përdorin data warehouse. Gjithashtu shumë e rëndësishme është të kemi një zyrë të menaxhimit të projektit ku do të kryhet ekzekutimi i projektit. Përdoruesit e sistemit apo pjesëtarët e ekipit do të jenë në gjendje të japin mendimet e tyre se si ata do të zgjidhnin sfidat e tyre aktuale. Ata gjithashtu do të marrin si detyrë pastrimin apo standardizimin e të dhënave aktuale të tyre.

Rezultatet e të pasurit data warehouse duhet të justifikojnë investimet kohore dhe shpenzimet monetare, dhe një kuptim shumë i qartë i sfondit është i nevojshëm për të kuptuar të gjitha implikimet e projektit para implementimit.

Kapitulli II

2 Data warehouseing

2.1 Çka është data warehouse?

Data warehouse është një depo e të dhënave të bashkuara, për t'i mundësuar përdoruesit fundor analizë të shpejtë të të dhënave. Këto të dhëna mirren nga burime të ndryshme të cilat ruhen në mjedise të ndryshme fizike. Data warehouse është një mjedis i cili përfshinë të gjitha aplikacionet dhe operacionet për të menaxhuar procesin e grumbullimit të të dhënave dhe dërgimin e tyre tek përdoruesit, e jo vetëm një bazë e të dhënave relacionale që përmbanë të dhëna historike të derivuara nga të dhënat transaksionale.

Data warehouse nuk ka një definicion standard dhe njerëzit që punojnë në të e kanë definuar në disa mënyra si më poshtë:

”Arkitektura bazë e data warehouse paraqet një depo të cilën ne e mendojmë si një sistem i madh dhe i vetëm i ruajtjes, i cili vlerësohet përafërsisht si një ndërmarrje e të dhënave, që ndërmjetëson përdoruesin fundor dhe burimet e të dhënave prodhuese“ [2].

“Data warehouse është kopje e të dhënave transaksionale të strukturuar në mënyrë specifike për raportim“ [1].

“Data warehouse është grumbullim i të dhënave i integruar, 'subject-oriented', i ndryshuar në kohë, dhe i paqëndrueshëm në mbështetje të procesit të vendimmarrjes së menaxhmentit“ [3].

Sipas William Inmon:

- **subject - oriented.** Data warehouse është i dizajnuar për të ndihmuar në marrjen e vendimit për një subjekt specifik. Psh., aplikacionet për të dhënat e shitjeve përmbajnë shitje specifike të produkteve specifike për

konsumatorë specifike. Të dhënat e orientuara në subjekt i japin një imazh stabil procesit të biznesit, të pavarur nga sistemi i trashëgimisë. Me fjalë të tjera, kap natyrën bazë të mjedisit biznesor.

- **integruar.** Data warehouse përbëhet nga lloje të ndryshme të të dhënave të cilat grumbullohen nga sisteme të ndara dhe kjo mund të shkaktoj konflikt dhe mospërputhje në njësitë matëse. Për shkak të kësaj ato duhet të vendosen në format konsekuent dhe kështu ato paraqiten të integruara.
- **nonvolatile.** nonvolatile nënkupton që të dhënat të cilat futen një herë në data warehouse ato më nuk mund të ndryshojnë. Kjo është logjike pasi qëllimi i warehouse është që t'i mundësoj përdoruesit të analizoj se çfarë ka ndodhur. Të dhënat e reja gjithmonë bashkangjiten në bazë të të dhënave e cila vazhdimisht absorbon të dhëna të reja, duke i integruar me të dhënat ekzistuese.
- **i ndryshueshëm në kohë.** në pikën e ndryshimit në kohë ka ndryshim ndërmjet të dhënave operacionale dhe informacionale. Të dhënat operacionale janë valide vetëm në momentin e qasjes. Kur kërkohen nevojat e performancës nevojiten të dhënat historike. Të dhënat në data warehouse paraqesin të dhëna për një periudhë të gjatë kohore; analizat historike mund të performohen më lehtë [3].

2.2 Qëllimet e data warehouse

Qëllimet themelore të data warehouse janë:

1. "I bën informatat e organizatës të qasshme." Të dhënat në data warehouse janë të qarta dhe të etiketuara me korrektësi. Mënyra e qasjes në të dhëna është shumë e lehtë dhe shumë e shpejtë. Këto cilësi mund të listohen si: të kuptueshme, të navigueshme, dhe me performancë të lartë.
2. "I bën informatat e biznesit konsekuente." Informatat konsekuente kanë rëndësi kyçe në data warehouse përderisa të dhënat grumbullohen nga pjesë të ndryshme të biznesit. Ato duhet të harmonizohen plotësisht. Nëse dy njësi të biznesit nuk nënkuptojnë të njëjtën gjë atëherë ato etiketohen në mënyrë të ndryshme.
3. "Të jetë burim i informatave të përshtatshme dhe elastike." Kjo mundëson të shtohen të dhëna të reja dhe të bëhen pyetësorë të rinj pa pasur nevojë për ndryshim të të dhënave dhe teknologjive ekzistuese.
4. "Të jetë bastion i sigurtë për ruajtjen e asetëve të pronarit." Data warehouse përveç kontrollimit të qasjes efektive në të dhëna, kompanisë i

jep një dukshmëri të mirë në përdorimin e atyre të dhënave, madje edhe pas largimit të tyre nga data warehouse.

5. “Të jetë bazë për marrjen e vendimeve.” Data warehouse siguron të dhëna të sigurta për marrjen e vendimeve. Vendimet janë paraqitje e data warehouse [1].

2.3 Aplikimi i Data Warehouse nëpër kompani

Më poshtë janë tri shembuj të data warehouse në kompani.

Kompani e shitjes

- Analizë e shitjeve
- Parashikim
- Përcjellje e inventarit

Prodhimtari e teknikës

- Matja dhe analiza e zingjirit të furnizimit
- Përfitimi i konsumatorit
- Partneriteti strategjik – negociimi me furnizuesin dhe konsumatorin
- Negociimi për kontrata
- Përfitimi sipas biznesit
- Analiza specifike për produktivitet dhe kualitet

Kompani për prodhimin e ushqimit

- Matja kundrejt konkurrencës
- Mundësia e projektimit si do të jetë produkti i ri
- Analiza e shitjeve sipas regjionit dhe dyqanit
- Mundësia e paraqitjes se si shkon shitja e produkteve në dyqanet konkurrencte, në dyqanet e të njejtit zingjir dhe kundrejt produkteve konkurrencte

- Analiza e kostos së prodhimit dhe performancës
- Analiza e produktivitetit
- Analiza e niveleve të artikujve
- Planet dhe parashikimet [4]

2.4 Elementet bazike të Data Warehouse

2.4.1 Sistemi burimor

Sistem burimor quhet sistemi trashëgimor i cili tërheqë të dhënat biznesore dhe transaksionet. Sistemi burimor duhet të jetë në dispozicion dhe jep mundësinë për të shpërndarë dimensionet bazike si të produktit dhe të konsumatorit me sistemet tjera trashëguese të kompanisë. Është burimi më i madh i të dhënave për sistemet e analizave prandaj mundëson krijimin e pyetësorëve dhe raporteve të menaxhmentit direkt nga këto sisteme.

2.4.2 Hapësira e paraqitjes së të dhënave

Hapësira e paraqitjes së të dhënave është hapësira fillestare e ruajtjes ku proceset që pastrojnë, transformojnë, kombinojnë, arkivojnë aplikohen në të dhëna në mënyrë që të përdoren pastaj në data warehouse. Hapësira e paraqitjes së të dhënave vepron si një urë ndërmjet sistemit burimor dhe serverit prezentues. Kufizimi kryesor i hapësirës së paraqitjes së të dhënave është se ajo nuk ofron pyetësorë dhe shërbime prezentuese.

2.4.3 Serveri prezentues

Serveri prezentues është një makinë fizike që ruan të dhënat e procesuara për kërkesat e shfrytëzuesve fundorë për pyetësorë dhe raporte. Ai furnizohet nga hapësira e paraqitjes së të dhënave. Nëse burimi i prezentimit të pyetësorëve për të dhënat e kompanisë organizohet rreth modelit me entitet relational, kuptueshmëria dhe performanca do të humbasin. Tabelat do të organizohen si skemë yll nëse serveri prezentues prezenton dhe ruan të dhënat në strukturë dimensionale.

2.4.4 OLAP (On-Line Analytic Processing – Procesimi analitik)

OLAP mundëson krijimin e pyetësorëve dhe prezentimin e të dhënave qofshin ato tekst apo numra, nga data warehouse për shfrytëzuesit fundorë. Teknologjia OLAP bazohet në kubin multidimensional të të dhënave dhe bazat e të dhënave OLAP kanë strukturë multidimensionale.

2.4.5 Aplikacionet për shfrytëzuesit fundorë

Këto aplikacione ndihmojnë shfrytëzuesit fundorë të krijojnë pyetësorë, të bëjnë analiza dhe të përmbushin aktivitete të tjera të cilat i përmbushin nevojat e kompanisë siç janë veglat për qasje në të dhëna dhe veglat për pyetësorë ad hoc.

Veglat për qasje në të dhëna për shfrytëzuesin fundor punojnë me sesion SQL dhe i ofrojnë shfrytëzuesit raport, shfaqje të të dhënave apo formë tjetër të analizës.

Vegla për pyetësorë ad hoc lehtëson përgatitjen e pyetësorëve duke i ofruar shfrytëzuesit mundësinë e përdorimit të pyetësorëve shabllon.

2.4.6 Aplikacionet modeluese

Aplikacionet modeluese mundësojnë transformimin apo përmbledhjen nga data warehouse sipas modelit të parashikimit, modelit të sjelljes së rezultateve, modelit të shpërndarjes dhe veglave për data mining.

2.5 Përfitimet e aplikimit të data warehouse

Përfitimet kryesore nga data warehouse janë listuar më poshtë:

- DW ofron qasje në informatat administrative për marrësit e vendimeve.
- I bën analizat e të dhënave më të lehta dhe më të shpejta. DW rrit produktivitetin e marrësve të vendimeve të kompanisë.
- Ekstraktimi i të dhënave nga burimi i tyre original në hapësira qendrore zgjidh problemin e performancës i cili lind gjatë nxjerrjes së analizave komplekse nga të dhënat operationale.
- Të dhënat në DW janë të ruajtura në mënyrë të specializuar dhe quhet bazë e të dhënave multidimensionalë. Kjo formë i bën më efektive dhe më të shpejtë pyetësorët e të dhënave.
- DW grumbullon sasi shumë të madhe të të dhënave. Në krahasim me bazat e të dhënave relacionale të dhënat në DW nuk është e nevojshme të jenë të normalizuara, në mënyrë që të shfaqen më shpejtë.

2.6 Faktorët kryesorë që mirren parasysh gjatë dizajnit të data warehouse

Faktorët kryesorë të cilët duhet të mirren parasysh gjatë dizajnit të DW janë:

Madhësia dhe arkitektura: kjo i referohet asaj se sa dëshiron kompania të jetë i gjerë DW i tyre dhe tërësisht mvaret nga nevojat e kompanisë. Por zgjidhja dhe plani duhet të bëhen sipas programit implementues në të cilin madhësia e projektit është konform madhësisë dhe nevojave të kompanisë. Duke pasur një plan të pararendinuar për madhësinë dhe arkitekturën e data warehouse ndihmon në mënjanimin e problemit “scope creep” i cili është shkaktari kryesor në dështimin e projektit të data warehouse.

Ndërveprimi: nëse kompania përdorë bazën e të dhënave në SQL, Oracle apo ndonjë tjetër bazë të të dhënave specifike të cilës i duhet të bashkëveprojë me ndonjë tip tjetër të bazës së të dhënave, atëherë çdo DW duhet të ofrojë ndërveprim ndërmjet formateve dhe platformave të bazës së të dhënave. E njëjta vlenë edhe për ndërveprimin ndërmjet sistemeve operative në nivelin e shfrytëzuesve fundorë: nëse jeni duke përdorur sistemin operativ Unix për menaxhim të një baze të të dhënave dhe Windows për një bazë të të dhënave tjetër duhet të vendoset për një zgjidhje e cila siguron se do të ketë ndërveprim të sistemeve operative.

Kostoja: kostoja është ndër faktorët kryesorë gjatë dizajnit të DW dhe pjesa e parë e projektit të DW e cila mund të shkojë keq nëse nuk planifikohet në përputhje me burimet e mundshme reale. Kostoja është e rëndësishme edhe në pikëpamjen strategjike kur bëhet planifikimi i madhësisë së DW. Kostoja i lejon kompanisë të bëjë zgjidhjen më relevante për nevojat e tyre, dhe të bëjë shfrytëzimin më të mirë të fondit duke evituar funksionalitetet e panevojshme nga DW.

Menaxhimi: kompania duhet të vendosë saktësisht se si duhet të ndahen përgjegjësitë për projektin e DW, dhe cilat njësi administrative do të jenë përgjegjëse për cilin lloj të informatave. Këto kompetenca duhet të qartësohen para zhvillimit ashtu që të mos ketë konfuzione se kush për çfarë është përgjegjës.

Mbështetja: nevoja për trajnime efektive gjithëpërfshirëse shpesh injorohet dhe mund të kushtojë deri në pesëmbëshjetë për qind të buxhetit të zhvillimit,

varësisht nga projekti në fjalë. Trajnimi është ndër gjërat e para të cilat duhet të mirren parasysh gjatë planifikimit të buxhetit për DW dhe është vendimtar në suksesin e projektit. Rekomandohet që të jetë një koordinator i trajnimeve që do të ketë në menaxhim gjithë procesin duke përfshi kohën, lokacionin, aranzhimin e materialeve, etj.

Mbështetja institucionale: profesionistët e teknologjisë përveç zgjedhjes së administratorëve dhe shfrytëzuesve duhet të sigurojnë edhe mbështetje të vizionit dhe procesit. Suksesi përfundimtar i DW mvaret shumë nga mbështetja e shfrytëzuesve fundorë brenda njësive të kompanisë.

Interpretimi dhe Funksionaliteti: siç është cekur nga Margaret Lester “Faktori i cilësisë së interpretimit në DW është në atë se sa do të kuptojnë shfrytëzuesit informatat nga raportet e DW“. Nëse administratorët nuk mund të kuptojnë përfitimin e shfrytëzuesve nga informatat dhe nëse informata nuk është interpretuese apo funksionale për shfrytëzuesit, kjo shkakton dyshim në vlerën e të dhënave të paraqitura.

Shtimi dhe fleksibiliteti: edhe pse shumë data warehouse paraqiten me një numër modest të qëllimeve fillestare, dizajni fillestar duhet të llogaritet mënyrën se si do të ndryshojnë këto qëllime kur ndryshojnë qëllimet e kompanisë. Çdo arkitekturë e data warehouse duhet të jetë në gjendje të ndryshohet pa shumë vështirësi dhe pa investime shtesë në kohë dhe kosto.

Privatësia/Siguria: shkalla në të cilën privatësia dhe siguria do të jenë çështje më të vogla ose më të mëdha mvaret nga definimi i shtrirjes. Të gjitha informatat duhet të jenë të mbrojtura në mënyrën më të mirë të mundshme dhe tipet e sigurisë dhe llojet e problemeve të privatësisë ndryshojnë varësisht se çfarë përmbanë informata në një data warehouse të mundshme. Arkitektura e paradefinuar e sigurisë gjithashtu u mundëson menaxherëve kontrollë më të rreptë mbi të dhënat, dhe u lejon atyre të sigurojnë më mirë biznesin. [5]

Kapitulli III

3 Arkitektura e sistemit

3.1 Modeli dimenzional

Modeli dimenzional i cili është i dizajnuar për të rritur performancën e pyetësorit dhe të jetë më i kuptueshëm, është një model alternativ i modelit me entitet relacional. Modeli dimenzional përbëhet nga tabela fakt dhe tabelat dimension.

Tabela fakt përmbanë matjet e kompanisë që preferohet të jenë numerike dhe shtuese. Aty duhet të ketë një set prej dy e më shumë çelësave të jashtëm që ndihmojnë lidhjen ndërmjet tabelës fakt dhe atyre dimension.

Tabela dimension është tabelë plotësuese e tabelës fakt. Shumë prej tyre janë me tipare tekstuale. Ajo gjithashtu ka çelësin kyç që mundëson lidhjen me tabelën fakt.

Procesi kryesor i organizimit dhe konfigurimit të të dhënave është faza e njohur si ‘modelimi dimenzional’, që është hapi që organizon dhe konfiguron destinacionin final të të dhënave. Kimball thekson: “Modelimi dimenzional është pranuar gjerësisht si qasje e preferuar për prezantim të DW/BI. Praktikuesit dhe ekspertët kanë pranuar se të dhënat e prezentuara në veglat e BI duhet të bazohen në thjeshtësi për të pasur shanse për sukses“ [1]. Kjo pohon se ai është më logjiku dhe më i përhapuri në praktikë për të transformuar të dhënat duke i denormalizuar ato në modelin dimenzional të përbërë nga tabelat fakt dhe dimension. Edhe pse është e mundur që me përdorimin e ETL të barten të dhënat në data warehouse dhe të bëhen të prezentueshme në të njëjtën formë si burimi, kjo nuk ka shumë kuptim dhe dështon në marrjen e avantazheve të benefiteve të arkitekturës së pranuar të data warehouse.

Për më tepër, nëse ndokush bënë përpjekje për të ndërtuar një data warehouse, ai arsyeton se shfrytëzuesit fundorë do t'i kenë në dispozicion të dhënat e tyre në mënyrën më të thjeshtë për BI të tyre.

3.2 Shtresat e data warehouse

Brenda fushëveprimit të data warehouse “ka katër komponente të ndara që mirren në konsideratë gjatë shqyrtimit të data warehouse – sistemi operativ i burimit, fusha e përqendrimit të të dhënave, fusha e prezentimit të të dhënave dhe veglat për qasje në të dhëna” [1].

Burim operativ janë bazat e të dhënave transaksionale në prodhim që kanë qenë lokacioni për të gjitha të dhënat tona.

Fusha e përqendrimit të të dhënave është një bazë e të dhënave e kufizuar për shfrytëzuesit, mirëpo është ndalesa e parë e të dhënave nga sistemi transaksional prej ku të dhënat vijnë së bashku nëpërmjet ETL dhe bëjnë transformimin e tyre para se të vazhdojnë në data warehouse aktual.

Fusha e prezentimit të të dhënave është data warehouse aktual i mbushur me të dhëna që janë në tabelat fakt dhe dimenzion, metoda standarde e formatimit të data warehouse. Shtresa e prezentimit i paraqet të dhënat shfrytëzuesve në formatin e dëshiruar për të marrë vendime me efektivitet.

Arkitektura fizike e data warehouse fillon në shtresën e përqendrimit të të dhënave të modelit të data warehouse. Vegla ETL e cila mundëson ekstraktim, transformim dhe ngarkim të të dhënave nga burimet e të dhënave, është një aplikacion vizuel që përdorë vegla të ndryshme GUI(graphic user interface) për të transportuar të dhënat nga burimi në destinacion brenda warehouse. Shumica e aplikacioneve ETL duhet të qëndrojnë në sisteme operative GUI siç janë Windows apo Linux, përderisa disa mund edhe të punojnë në sistemin operativ UNIX. Kur kemi bazë të të dhënave që do të ruaj sasi të madhe të të dhënave, më së miri është që kjo bazë e të dhënave të vendoset në fushën gjenerale ku do të vendoset edhe data warehouse ashtu që të dhënat të mos kenë nevojë të lëvizin nëpër servera. Pasi që këto baza të të dhënave mund të jenë të mëdha, ato mund të kopjojnë shumë shpejtë shumicën e të dhënave nga bazat e të dhënave transaksionale, kjo duhet të mirret në konsideratë së bashku me hapësirën e nevojshme për data warehouse kryesor.

Duke filluar nga memorja, procesori dhe veçanërisht hapësira duhet të jenë në krye të listës së prioriteteve gjatë blerjes së harduerit për zhvillim. Kompanitë nuk duhet të marrin parasysh vetëm nevojat e sotme të bazës së të dhënave për instalim të projektit, por edhe çfarë përmirësimesh në data warehouse do të jenë të nevojshme në të ardhmen.

Kimball thekson: “shitësit më të mëdhenj të bazave të të dhënave relacionale janë ende platforma të zgjedhjes, duke mbuluar rreth 80% të tregut të DW/BI” [1]. Edhe pse ndoshta është e qartë se cilit sistem të bazës së të dhënave i referohet ai, është e domosdoshme të sigurohemi se këto sisteme mund të merren me madhësinë potenciale dhe nevojat e hapësirës që do të jenë të nevojshme, ndoshta në rangun terrabyte të shoqëruar me ndarje të arsyeshme të diskut. Gjatë planifikimit të hapësirës kompanitë gjithashtu duhet të mendojnë për planin për backup dhe rikthim të warehouse, veçanërisht backup fajllat mund të jenë shumë të mëdhenj.

Shtresa e qasjes në të dhëna kërkon një mjedis krejtësisht të ndryshëm. Edhe pse janë të mundshme teknologjitë e njehta të mbivendosjes, nuk mund të strehohen të gjitha në një lokacion, pasi sistemet dhe shtresa e data warehouse duhet të vendosen ndaras nga njëra tjetra. Në rastin e shtresës për qasje në të dhëna është e nevojshme një server për aplikacion. Për shtresën e të dhënave, “ka serverë që trajtojnë qasjen në të dhëna nga uebi, menaxhimi i pyetësorëve, raportimi në ndërmarrje, autentifikimi, bazat e të dhënave metadata, etj.” [1].

Pavarësisht kësaj, nevoja më e madhe për këtë shtresë i referohet pjesëve të uebit dhe aplikacionit që i japin shfrytëzuesve qasje të lehtë dhe të pastër në të dhënat e tyre nga veglat mbështetëse.

Mund të bëhet zgjedhja e platformës si aplikacioni SAP Business Objects i cili mund të veproj lehtësisht në Windows apo UNIX. Kompania duhet të vlerësojë se cila i përshtatet më së shumti situatës së kompanisë.

3.3 Metadata

Metadata përmbajnë informacionet dhe definicionet për të dhënat e ruajtura.

Elementet bazë të data warehouse janë dhënë në figurë:

Basic elements of the data warehouse




Figura 2. Elementet bazë të data warehouse

3.4 Tregu i të dhënave (Data marts)

Tregu i të dhënave është një nëngrup logjik i gjithë data warehouse dhe i përgatitur për një proces të vetëm biznesi në kompani. Kur këto bashkohen formohet një data warehouse i integruar e kompanisë. Tregu i të dhënave duhet të formohet nga faktet dhe dimensionet. Kështu ato mund të kombinohen dhe përdoren bashkërisht.

3.4.1 Çka është tregu i të dhënave

Tregu i të dhënave është model i cili paraqet strukturën e njëjtë të të dhënave me atë të data warehouse. Ato janë të përgatitura për kërkesa specifike të gjithë kompanisë apo një pjese të saj. Tregu i të dhënave i jep disa përparësi shfrytëzuesve pasi përmbanë më pak të dhëna. Së pari u mundëson të punojnë me pyetësorë më të shpejtë. Përparësi tjetër është lëvizshmëria pasi kërkon më pak hapësirë në disk që do i jep mundësi shfrytëzuesit të merr tregun e të dhënave në laptop. Gjatë procesit të dizajnit të tregut të të dhënave është e mundur të ndiqen dy metoda të ndryshme për të mbledhur të dhënat. Njëra zgjidhje është të mbledhen të dhënat nga data warehouse e kompanisë dhe pastaj t'i procesoj ato sipas nevojave mbi të cilat është përgatitur tregu i të dhënave,

zgjidhja tjetër është të mbledh të dhënat e formuara direkt në tregun e të dhënave. Të dhënat të cilat janë dizajnuar sipas kërkesave të tregut të të dhënave pastaj mbahen në një depo qendrore të të gjitha të dhënave të kompanisë. Këto zgjidhje mund të shihen në figurë.




Figura 3. Arkitektura informative e ndërramrjes

Tregjet e të dhënave mund të kenë strukturë të varur apo të pavarur. Nëse karakteristikat e dimensioneve të tregut të të dhënave përcaktohen në fillim se si të përputhen njëra me tjetrën, atëherë ky treg i të dhënave do të ketë karakteristika të varura. Në disa raste është më mirë të kemi treg të të dhënave të pavarur. Karakteristikat e tregjeve tjera të të dhënave nuk do të mirren parasyshë gjatë përgatitjes së tregut të të dhënave. Megjithatë, kjo mund të pengoj integrimin në të ardhmen dhe do të shtoj koston e zhvillimit nëse do të ketë interesim në përhapjen e informatave ndërmjet departamenteve.

3.5 Shtigjet e zhvillimit të tregut të të dhënave

Për zhvillimin e tregut të të dhënave i kemi tri shtigje kryesore: shtegu lart-poshtë, shtegu poshtë-lart dhe shtegu i federuar.

3.5.1 Shtegu Lart-Poshtë

Sic shihet në figurën e mëposhtme të dhënat fillimisht vijnë në fushën data staging nga burimet operationale dhe në këtë fushë të dhënat kalojnë nëpër disa procese. Pas kësaj bëhet transferimi në data warehouse i cili pastaj i pason ato në tregun e varur të të dhënave.




Figura 4. Shtegu lart - poshtë

3.5.2 Shtegu Poshtë-Lart

Në këtë shteg të dhënat të cilat vijnë nga sistemet trashëguese në fushën data staging, rrjedhin direkt në tregjet e të dhënave të pavarura dhe pastaj këto tregje të të dhënave mbushin data warehouse të kompanisë siç shihet edhe në figurë:




Figura 5. Shtegu poshtë – lart

3.5.3 Shtegu i Federuar

Me shtegun e federuar kemi të dy llojet e tregut të të dhënave edhe të varur edhe të pavarur, siç shihet në figurën 6. Tregu i pavarur i të dhënave i mbledh të dhënat direkt nga fusha data staging, kurse tregu i varur i të dhënave i merr të dhënat nga tregu i të dhënave.




Figura 6. Shtegu i federuar

3.6 Dallimet ndërmjet data warehouse dhe tregut të të dhënave

Gjatë krahasimit të tregut të të dhënave me data warehouse mund të vërejmë lehtë dy dallime themelore. Njëra prej tyre është se tregu i të dhënave është një nëngrup i data warehouse dhe është i orientuar në kërkesa. Përkundër kësaj data warehouse përmbanë të dhëna të kompanisë pa u bazuar në kërkesa specifike. Por natyrisht, gjatë dizajnit të tregut të të dhënave duhet të mirret parasysh e gjithë struktura e data warehouse, nëse kjo nuk mirret parasysh atëherë do të jetë shumë i vështirë integrimi i mëvonshëm i tregut të të dhënave.

Implementimi i tregut të të dhënave është më i shpejtë dhe më i lirë, derisa ai përmbanë vetëm pjesë specifike të data warehouse, implementimi i së cilës merr më shumë kohë dhe ka kosto më të lartë.

Ka shumë zgjidhje të tregut të të dhënave që janë zhvilluar nga shitës të sistemeve mbështetëse për vendimmarrje. Por përdorimi i tyre për të dizajnuar një treg të të dhënave me kërkesa specifike kërkon përpjekje më të madhe për të rregulluar ato; për shkak se ato zgjidhje janë prodhuar për qëllime gjenerale.

Diferenca tjetër kryesore e tregut të të dhënave nga data warehouse është se të dhënat në tregun e të dhënave mund të jenë më të shpërndara se në data warehouse. Megjithatë kërkesat e tregut të të dhënave janë më të definuara se ato të data warehouse, grumbullimi i të dhënave mund të bëhet përgjatë kërkesave. Pra nxjerrja e të dhënave mund të bëhet në mënyrë më të shpejtë dhe më efikase.

3.7 Skema yll

Skema yll është pika qendrore e zhvillimit të data warehouse, pasi ajo siguron një strukturë të denormalizuar të bazës së të dhënave për raportim të të dhënave që janë të nevojshme për nevojat e kompanisë. Skema yll thjeshtë përkufizohet si “dizajn dimenzional për bazë të të dhënave relacionale“. Kjo skemë emrin e ka marrë nga pamja, që shfaqet si formë e yllit me tabelat dimenzion që rrethojnë pikën qendrore të skemës, që është tabela fakt. Çelësat zëvendësues janë çelësa primar të indeksuar në numra të plotë të tabelës dimenzion i cili bëhet çelës i huaj vetëm për lidhje me tabelën fakt, dhe kjo krijon bazën e skemës yll. Posa të vendosen lidhjet në tabelat dimenzion, ylli fillon të marrë formë, dhe kjo është shumë e zakonshme në data warehouse. Tabela fakt posedon shumë çelësa që lidhen me tabelat dimenzion dhe kështu mundësohet skema yll. Meqenëse tabela fakt përshkruan një proces të biznesit, “ajo duhet të përmbajë një grup gjithëpërfshirës të matjeve, edhe pse disa janë të tepërta“. Kjo siguron mundësinë për të bërë raportim më të lehtë duke i pasur të dhënat në dispozicion në atë tabelë.

Tabela më e ngjashme me atë të burimit të të dhënave dhe më e vlefshme në skemën yll është tabela dimenzion. Tabela dimenzion përmbanë pjesën më të madhe të të dhënave në data warehouse, dhe ka për detyrë të ruajë atributet e të dhënave për bartje të mëvonshme në tabelën fakt. Tabela dimenzion do të “përbëhet nga lidhja e fortë e një grumbulli të attributeve për të paraqitur objektet kyçe të biznesit, siç janë produktet, konsumatorët, punëtorët apo pajisjet“ [1]. Tabela dimenzion do të përmbajë psh. në një tabelë adresën e ndokujt dhe të gjithë emrat lidhur me të në një tabelë tjetër dimenzion. Tabelat dimenzion janë tabelat më të mëdha në data warehouse në krahasim me tabelat fakt dhe përmbajnë të dhëna raportuese nëse bëjmë pyetësorë në ta. Gjatë procesit ETL të dhënat së pari do të mbushen në tabelën dimenzion pasi ajo do të ketë çelësin primar që më pas do të referohet nga tabela fakt. Çelës primar i tabelës fakt do të jetë fusha e indeksuar nga tabela dimenzion e cila është me numra të plotë që rriten për një, e njohur si kolonë identitet në SQL Server. Kjo ID e tabelës dimenzion do të kopjohet në tabelën fakt për qëllime referuese gjatë procesit ETL.

3.8 Skema snowflake

Kemi edhe një skemë tjetër në data warehouse të njohur si skema snowflake, dhe kjo është një mënyrë tjetër për të lidhur të dhënat me skemat yll ekzistuese.

Kjo skemë do të shfaqet kur “lidhjet ndërmjet attributeve të dimensioneve bëhen të qarta në dizajnin dimensional“. Duke pasur të dhëna të ngjashme në disa baza të të dhënave apo në të njejtën bazë të të dhënave, është e mundur të ekzistojë një lidhje brenda skemave yll varësisht nga nevojat që do të lindin në kuadër të kërkesave të kompanisë.

Sikurse skema yll që e merr emrin nga forma që e merr gjatë dizajnit, edhe kjo skemë e merr emrin nga degëzimet që i bëhen skemës yll në tabelat dimensionale.

3.9 Mbushja dhe procesi ETL

Njëra nga pjesët më të rëndësishme të data warehouse është ekstraktimi, transformimi dhe mbushja e të dhënave nga bazat e të dhënave operative transaksionale në vetë data warehouse.

Edhe pse është e mundur të ndërtohet një ETL që do të kompletoj detyrën e saj ndërmjet bazës së të dhënave transaksionale dhe skemës yll të data warehouse, është më e logjikshme të ekstrahohen të dhënat dhe të ruhen përkohësisht para se të transformohen. Fusha e përqendrimit të të dhënave ekziston vetëm për të tërhequr të dhënat nga sistemi operativ, pastaj të riaranzhoj dhe pastroj të dhënat para se të ngarkohen në data warehouse.

Një data warehouse, e veçanërisht një e tillë për një ndërmarrje ka të dhëna që vijnë nga burime të ndryshme dhe kjo e bën ETL që të veproj më gjatë. Prandaj, tërheqja e shpejtë e të gjitha burimeve të të dhënave ka kuptim në këtë shkallë. Pasi të mirren të dhënat nga bazat e të dhënave transaksionale, duke i mbajtur të dhënat larg nga operacionet biznesore dhe në një vend të izoluar, ETL i ipet mundësia të transformoj të dhënat me lehtësi. Pasi të dhënat të kalojnë transformimin në mënyrë të arsyeshme, të dhënat pastaj kalojnë nëpër një hap të lehtë të ETL ku mbushen tabelat fakt dhe dimensionale të data warehouse.

Nuk ka analogji më të mirë të kësaj pjese të data warehouse se definicioni i Kimballit për fushën e përqendrimit të të dhënave të procesit ETL. Ai thotë se kjo krahasohet me kuzhinën e një restorani ku ushqimi i papërpunuar bëhet ushqim i mirë që konsumatorët do ta shijojnë. Kimballi e sheh krahasimin si: “në data warehouse, të dhënat operationale të papërpunuara transformohen në mënyrë të përshtatshme në warehouse për përodrim dhe pyetësorë nga shfrytëzuesit.“ [1] Duke marrë një hap më tej, hapi kur ushqimi bëhet i gatshëm, kuzhinieri i trajnuar do ta kompletoj detyrën e tij ashtu si një zhvillues i trajnuar i

BI do të krijoj një ETL për të vepruar njëjtë me të dhënat. Për më tepër, sikurse konsumatori i cili nuk ka gjasë të shohë kuzhinën se ku përpunohet ushqimi, ashtu edhe shfrytëzuesi nuk do të dijë për bazën e të dhënave që i përmbanë të dhënat.

Një nga arsyet kryesore që fusha e përqendrimit të të dhënave është e nevojshme të fillojë procesin e punës me sasi të madhe të të dhënave që krijojnë data warehouse final të organizuar. Në përkufizimin më të thjeshtë, arsyeja pse është e nevojshme kjo fushë është: për shkak të cikleve të ndryshme të kompanisë, kufizimet e harduerit dhe rrjetit dhe faktorët gjeografik, nuk është i mundur ekstraktimi i të gjitha të dhënave nga të gjitha bazat e të dhënave operacionale në kohë të njëjtë. Përderisa të dhënat vijnë nga burime të ndryshme dhe në forma të ndryshme, është e nevojshme që të ketë një vend për këto të dhëna në operacionet me shkallë të lartë të lëvizjes së të dhënave. Një shembull do të ishte që në sferën e data warehouse për kompaninë, të dhënat që vijnë nga sistemi i financave apo leximeve duhet të ekstrahohen shumë më shpesh se që do të duhej një bazë e vogël e të dhënave që ka të bëjë me sistemin e komunikimit.

Një tjetër përparësi e të pasurit të ruajtura të dhënat operacionale është mundësia për të ditur më shumë rreth të dhënave që do të ngarkohen në data warehouse për të përcaktuar cilësinë e të dhënave që shfrytëzuesit dëshirojnë të raportojnë në portalin e ri të tyre të BI. Aftësia për të marrë pjesë në profilizimin e të dhënave u jep teknikëve të data warehouse një grumbull standardesh që duhet ndjekur dhe të testojnë të dhënat që vijnë nga bazat e të dhënave transaksionale. “Profilizimi i të dhënave është analizimi i burimit të të dhënave për të kuptuar gjendjen e burimit të të dhënave“ [6], dhe i jep stafit të IT-së mundësinë për të analizuar të dhënat dhe të fillojnë rrugën për në data warehouse. Një përparësi e këtij hapi është se kur fillon faza e ekstraktimit të të dhënave, nëse numri i tyre është jonormalisht i madh apo i vogël, bëhen të mundura disa veprime nga ana e stafit për të përcaktuar nëse ka ndonjë gabim në ETL, apo duhet të ndryshojë ndonjë gjë në ETL ashtu që të veproj më me efikasitet. Mund të ketë edhe analiza statistikore që paraqesin përparësitë e të paturit një data warehouse në kompani, ashtu që menaxhmenti të shohë numrat përmbledhës që tregojnë investimet e tyre.

Me të dhënat e nxjerra në mënyrë të sigurtë nga bazat e të dhënave transaksionale, ndoshta pjesa më e favorshme e fushës së përqendrimit të të dhënave është mundësia e transformimit të të dhënave ashtu që raportimi në data

warehouse të jetë më i forcuar. Ndonëse të dhënat në bazat e të dhënave operacionale janë më efikase dhe padyshim më korrekte për aplikacionet që i mbështesin, mundësia e transformimit të të dhënave për data warehouse është një hap vendimtar dhe përparësia kryesore e operacioneve ditore të data warehouse. Përveç të dhënave të cilat janë tashmë nga bazat e të dhënave transaksionale, ekziston mundësia e riorganizimit të të dhënave në formë të tabelave të përkohshme, si dhe mënyra të tjera të transformimit të të dhënave të pa përpunuara para se të dërgohen në data warehouse. Një tjetër alternativë është trajtimi i temave tabu të standardizimit të të dhënave që nuk është i mundur në sistemet e mëparshme të aplikacioneve dhe të cilat kanë krijuar zakone të këqija të shfrytëzuesit. Kështu, “standardizimi dhe koordinimi i të dhënave është një grup i proceseve që kryesisht përbëhet nga dizajnimi dhe ekzekutimi, puna e standardizimit është të krijoj njëtrajshmëri ndërmjet elementeve specifike të të dhënave“ [6].

Ekzistojnë mundësi të mrekullueshme kur bëhet fjalë për transformimin e të dhënave, të cilat në të kaluarën nuk kanë mundur të ndryshohen. Kimball thekson se: “ka transformime të shumta të mundshme, të tilla si pastrimi i të dhënave (korigjimi i gabimeve drejtshkrimore, zgjidhja e konflikteve të domenit, apo parsimi në format standarde), kombinimi i të dhënave nga burime të ndryshme, dhe caktimi i çelësave në warehouse“ [1].

Duke pasur të dhëna nga burime të ndryshme por për një destinacion të vetëm kërkon ndërhyrjen e ETL për të kthyer të dhënat konform standardeve. Me transformime tjera në dispozicion sikurse vegla SQL Server Integration Service ETL, ekziston mundësia e shtimit të kolonave bazuar në derivimin e të dhënave.

Fusha e përqendrimit të të dhënave është njëra nga pjesët më të rëndësishme të data warehouse pasi ofron mundësinë e organizimit të të dhënave nga të gjitha burimet në një vend para se të dërgoj të dhënat në destinacionin final ku shfrytëzuesit kanë mundësinë të bëjnë pyetësorët. Sikurse analogjia e Kimballit me kuzhinën e restorantit, kjo fushë nuk do të jetë transparente për shfrytëzuesit përveç zhvilluesve përgjegjës për ETL. Edhe pse nuk është e nevojshme, duket të jetë vendim i drejtë të vendosen të dhënat para se të mbushet data warehouse, veçanërisht me një sistem më të madh apo fushëveprim të data warehouse. Përdërisa kemi të dhënat e vendosura në një vend, i jep mundësinë ETL të kompletoj hapin e mesëm të transformimit të të dhënave dhe të mënjanoj ndonjë

anomali gjatë rrugës. Pas kompletimit, hapi tjetër është mbushja me të dhëna e tabelave fakt dhe dimenzion.

3.10 Alternativa ETL

Ka shumë mënyra për të ndërtuar një skemë yll, por tradicionalisht rruga më e mirë është të dizajnojmë skemën bazuar në nevojat e kompanisë. Megjithatë, ka disa raste kur skema yll mund të gjenerohet bazuar në të dhënat hyrëse. Tre akademikët kanë shpikur një mënyrë gjithëpërfshirëse për të gjeneruar skemën e data warehouse duke u bazuar në bazën e të dhënave transaksionale dhe programin e zhvilluar për vlerësim të të dhënave. Në këtë rast, ata dallojnë propozimin e tyre duke pohuar se “puna nuk kufizohet në dizajnimin e skemës por ajo gjithashtu popullon të dhënat nga burimet e grumbulluara të të dhënave në tabela të skemave të gjeneruara automatikisht” [7]. Ata përdorin grumbullimin hierarkik për të ndihmuar gjenerimin jo vetëm të skemës yll por edhe të skemave tjera. Programi i tyre gjeneron skemën dhe pastaj vendos produktin final në serverët e bazave të të dhënave. Një program i tillë është një përmirësim i madh mbi modelimin e zakonshëm dhe zhvillimin manual të skemës yll e pastaj dizajnimi dhe programimi i ETL për të futur të dhënat në data warehouse. Modeli i propozuar i tyre për skema automatike është i përbërë nga disa pjesë për të përfunduar procesin e marrjes së të dhënave të pa përpunuara në skemat eventuale në data warehouse. “Komponenti gjithashtu trajton parametrat e grumbulluar të cilët përfshijnë metodën e lidhjes (i vetëm, komplet apo mesatar), drejtimet e grumbulluara (rreshtat, kolonat, të dyjat) dhe matjen distancë/ngjashmëri (përputhje Euklidiane, Menhatane, Të thjeshtë për koeficientin korelacional të Pearson-it)” [7]. Kjo është e rëndësishme pasi grumbullimi hierarkik është përbërës në hapin e ardhshëm që përdoret për të degjeneruar skemën. Në shtresën tjetër, të dhënat e grumbulluara bëhen pjesë e gjenerimit të skemës duke lexuar në të dhënat e grumbulluara në hapin e mëparshëm. Pastaj, përcaktohet lloji i tabelës i cili është fakt apo dimenzion dhe gjithashtu përcaktohen lidhjet ndërmjet tabelave. Dhe në fund, të dhënat kalojnë në tabelat finale që përbëjnë skemën e dëshiruar, qoftë ajo yll, snowflake apo galaktikë.

Autorët pastaj demonstrojnë përdorimin e mjetit të tyre duke përdorur të dhëna nga një tekst fajll që përfundojnë në skemën yll. Ata tregojnë se për eksperiment kanë përdorur algoritmin Euklidian, dhe “arsyeja për këtë zgjedhje është se distanca Euklidiane është se kjo distancë përdoret më së shumti në analiza” [7]. Programi të cilin e përdorin për të ekzekutuar procesin është një

program bazik C#, i cili i ka ndjekur hapat e nevojshëm për të krijuar një skemë yll për këtë eksperiment. Është interesante të mendohet se kjo metodologji që përdorë një algoritëm do të jetë më efektive se dizajnimi, ndërtimi dhe ngarkimi manual i skemës nëpërmjet ETL. Megjithatë, është diskutabile nëse ky lloj programi është i përshtatshëm për të gjitha situatat apo do të jetë unik sikurse ETL, mirëpo padyshim se nëse ky program do të përdoret në mënyrë univerzale do të kursente shumë kohë. Në data warehouse të ndërmarrjeve ku të dhënat hyrëse vijnë nga të gjithë sistemet e ndërmarrjes, ndoshta një aplikim individual për secilën hyrje do të ishte e arsyeshme.

3.11 Biznis Inteligjenca

Edhe pse shumica e bazave të të dhënave që përdoren në kompani kanë nga një aplikacion për përdorim më të lehtë të tyre, data warehouse është vetëm një bazë e madhe e të dhënave që nuk ka një shtresë të aplikacionit. Megjithatë ka aplikacione që janë pjesë e data warehouse, por ato janë aty për të plotësuar depon si komponentë që ofron qëllime të ndryshme. Së pari, aty kemi një aplikacion ETL(Extract, Transform, Load) që është pjesë e zgjidhjes që bartë të dhënat nga baza e të dhënave burimore e transaksioneve. Aplikacionet më të njohura ETL janë: SQL Server Integration Services, OBIEE nga 'Oracle and Informatica'. Pjesa më e njohur e data warehouse janë veglat për raportime që përodren si pjesë e shtresës së prezentimit. Aplikacioni i raporteve nuk është pjesë e data warehouse, por është pjesa që paraqet data warehouse dhe me të cilën shfrytëzuesit janë të familjarizuar. Ka një mori veglash për të nxjerrë të dhënat nga data warehouse, të cilat janë zakonisht homogjene me data warehouse ashtu që mund të përodren me baza të tjera të të dhënave për raportime apo prezentim të të dhënave. Megjithatë, pjesa më e rëndësishme është aplikacioni i cili përmbanë pjesën e prezentimit, e cila është komponentë e përhapjes së informacionit, e veçantë e raportimit.

3.12 Raportimi

Tani më shumë se kurrë më parë, kompanitë mbështeten në informata të sakta, të sigurta dhe më të freskëta në raportet e tyre për të ndihmuar operacionet e tyre të biznesit dhe në përputhje me rregulloret gjithnjë e më të rrepta.

Çështja është se mund të ketë të dhëna në lokacione të ndryshme, dhe ato jashtë IT-së mund të nxjerrin raporte pa marrë parasyshë saktësinë e të dhënave. Rastet e tilla mund të parashtrojnë pyetje në lidhje me besueshmërinë e të dhënave në raport dhe mund të dërgojnë në vendime jo të mira dhe çështje

ndoshta edhe më të mëdha në vazhdim. Në kontekstin e të pasurit një data warehouse në kompani, veglat BI sigurojnë shpërndarjen në kohë të të dhënave për raportim dhe analizim nëpër ndërmarrje. Përveç kësaj, mjetet të cilat menaxhojnë, konsolidojnë dhe shpërndajnë të dhënat gjithashtu përmbajnë një gjurmë të auditimit të të dhënave, prej nga vijnë, çka është bërë me to, dhe kush i pranon ato. Një zgjidhje efektive e BI duhet të siguroj shpërndarjen në kohë të të dhënave, të lejoj raportimin dhe analizimin nëpër ndërmarrje, të ofroj vegla lehtë të përdorshme për menaxhim, konsolidim dhe shpërndarje të të dhënave dhe më e rëndësishmja është të përmbajë gjurmë të auditimit të të dhënave. Pika kulmore e data warehouse është se me çfarë efektiviteti zgjidhja e BI ndërvepron me të dhënat. Veglat më të njohura për raportim janë SAP Business Objects, IBM Cognos, Jaspersoft dhe Pentaho.

Arsyet për të marrë parasysh se kur duhet blerë e kur duhet zhvilluar raportet përfshijnë: numrin total të raporteve, shpërndarjen e dëshiruar dhe aftësitë ad-hoc. Me veglat superiore në dispozicion, pyetja me të cilën ballafaqohen bizneset gjatë implementimit ende është: a duhet blerë apo zhvilluar vegla për raportim për nevojat tuaja të BI.

Kur vendoset se cilën vegël BI duhet përdorur, për shkak të investimeve të konsiderueshme dhe shqetësimit në lidhje me përdorshmërinë, menaxhmenti duhet të përcaktoj llojin më të mirë të produktit për ta zbatuar. Nivelet e modelit rriten bazuar në produktet tradicionale dhe standarde të BI që janë implementuar.

Në “Magic Quadrant for Business Intelligence Platforms“ nga Gartner Research, kuadranti paraqet ku qëndrojnë veglat BI në krahasim me të tjerat kur analizohet ndikimi i veglës BI.

Kuadranti përfshinë lojtarët e ngrohtë, sfiduesit, udhëheqësit dhe vizionarët. Boshti vertikal paraqet aftësinë për të ekzekutuar, ndërsa boshti horizontal paraqet plotësinë e vizionit. Liderët dhe lojtarët e ngrohtë kanë më së shumti grupe, pasi liderët janë më të njohurit, ndërsa lojtarët e ngrohtë janë pjesë e një nevoje të caktuar të biznesit. Artikulli harxhon kohën duke kërkuar në trendet e tregut se çfarë kërkojnë shfrytëzuesit nga veglat BI dhe ku janë preferencat e tyre këto ditë. Ata ecin nëpër çdo produkt, duke përfshirë veglat më të njohura të kompanive të mëdha, si SAP, Microsoft dhe Oracle, dhe diskutojnë për pikat e forta dhe dobësitë që lidhen me çdo vegël.

Pavarësisht aplikacioneve që janë sinonim me BI që kanë të bëjnë me data warehouse, vegla e parë e cila përdoret në shtresën e prezentimit është vegla bazë për pyetësorë. Vegla për pyetësorë “i lejon shfrytëzuesit të krijoj pyetësorë direkt në modelin dimensional dhe të përcaktoj një grup rezultatesh“ [1]. Këtë vegël zhvilluesit e BI do ta përdorin edhe për të zhvilluar pyetësorë për të zhvilluar raporte të reja apo zgjidhje të data mining.

“Qëllimi i gjenerimit të raporteve është të transformojnë të dhënat në informata për shfrytëzuesit e biznesit“ [8]. Vegla më e popullarizuar do të jetë ende raportimi ad-hoc me të cilën shumica e shfrytëzuesve janë të familjarizuar. Veglat më të popullarizuara të raportimit mbeten SAP Crystal Reporting Tool dhe Report Builder nga Microsoft. Vegla e Microsoft-it Report Builder është shtuar në SQL Server 2008. Ashtu si drejtohen raportet Crystal në Business Object Enterprise, raportet e Microsoft-it janë zhvilluar në SQL Server Reporting Service, të cilat veprojnë me të njëjtin kapacitet si vegla ueb për shpërndarjen e raporteve të shfrytëzuesit.

Këto magazina të raporteve i japin departamentit të IT-së mundësinë e qeverisjes me qasje në raportet përfshirëse në data warehouse, dhe ata i japin gjithashtu shfrytëzuesve mundësinë të tërheqin të dhënat në vend se të gjenerojnë raporte për ta si në të kaluarën. Një nga tendencat më të popullarizuara ditëve të sodit që merr avantazh në implementimin e data warehouse është përdorimi i ‘dashboards’, i cili i ofron mundësinë shfrytëzuesit për ndërveprim gjatë marrjes së informatës. “Dashboard-i siguron mjetet e ndërfaqeve që mbështesin raportimin e statuseve dhe alarmeve nëpër burime të ndryshme të të dhënave në nivele të larta, dhe gjithashtu lejon kërkimin më të detajuar të të dhënave“ [1]. Një dashboard tipik zakonisht përfshinë datasetet, grafet, treguesit kyç të informatës dhe të dhënat përfshirëse. Një nga përparësitë e përdorimit të dashboard është se në shumë raste do të jetë interaktive me shfrytëzuesit dhe është në gjendje të paraqes projeksione për t’iu mundësuar shfrytëzuesve të marrin vendime më të mira. Dashboard-i ka synim grupet e vogla apo audiencën e targetuar, pasi janë të orientuara në detaje të hapësirave specifike. Universiteti i Floridës shpjegon kalimin e tyre nga sistemi i vjetër i raportimit në dashboard në ndërthurje me data warehouse të tyre: “Ky ishte një ndryshim thelbësor. Para kësaj, ne kemi ofruar tipin e planifikimeve të të ardhurave tona në raporte me format spreadsheet. Dhe kjo tërësisht ka kaluar në sistem online ku njerëzit mund t’iu qasen të dhënave që u nevojiten dhe mund të krijojnë pyetësorë për të marrë të dhënat në formatin e dëshiruar.“ [9]

Tjetër përdorim i popullarizuar i BI në mjedisin e data warehouse është mundësia për të përdorur OLAP (Online Analytical Processing) të avansuar dhe data mining. OLAP mund të organizoj të dhënat në struktura shumë dimensionale për t'iu mundësuar shfrytëzuesve të zgjedhin dimensionin që dëshirojnë ta shohin.

Data mining do të “eksploroj të dhënat në data warehouse për modele dhe marrëdhënie të dobishme“ [1]. Vegla e popullarizuar për këtë është SQL Server Analysis Services, e cila është vegël e fuqishme analitike e përfshirë në kompletin e produkteve të BI. Vegla i jep mundësi shfrytëzuesit të dizajnoj kubet bazuar në skemën yll të data warehouse, pastaj shton matjet dhe indikatorët kyç të performancës të njohura si KPI(Key Performance Indicators).

Të gjithë shembujt e raportimeve i japin shfrytëzuesit mundësinë të konsolidoj të gjitha të dhënat në data warehouse dhe të krijoj një version të vetëm, i cili është thelbësor në saktësinë e raporteve. Kemi shumë vegla në dispozicion për përdorim në sistemin BI dhe ka burime për të gjetur se cili punon më mirë për kompaninë. Pasi shumë nga veglat DW/BI janë të ngjashme për nga natyra dhe fushëveprimi, më e rëndësishme për shfrytëzuesit është se i përshtaten mirë biznesit. Në përgjithësi, Kimball konkludon se veglat e BI duhet të jenë praktike, me përmbajtje të pasur, të pastra, aktuale, dhe interaktive dhe të orientuara në vlera.

Duke pasur një data warehouse, kompania mund të përfitojë nga teknologjitë më të reja që janë në dispozicion në këtë fushë dhe të fuqizojë shfrytëzuesit për të marrë vendime më të mira me informacionet që i kanë në dispozicion.

3.13 Implementimi

Ky kapitull përfshinë një shembull të implementimit të data warehouse në kompani, në një shkallë të vogël që përmbanë vetëm një skemë ‘snowflake’. Zgjidhja e paraqitur këtu është një shembull që përdorë veglat e biznes inteligjencës me SQL Server dhe bazë të të dhënave në SQL Server, i njëjti softuer që është i përshtatshëm edhe për implementim të tërësishëm.

3.14 Prototipi i data warehouse së ndërmarrjes

Kulminacioni i tezës vjen së bashku me prototipin e data warehouse në kompaninë KEDS. Qëllimi i këtij dizajni fillestar të data warehouse është të paraqes jo vetëm se si një seri e tabelave mund të bëhen një skemë ‘snowflake’ e

denormalizuar, por gjithashtu të paraqes se si data warehouse në kompani mund të integrojë bashkë të dhënat ndërmjet sistemeve të ndryshme.

Hapi i ardhshëm është marrja e të dhënave nga baza e të dhënave duke i ekstraktuar ato, pastaj të transformohen për t'i vendosur në grupe logjike, dhe në fund të ngarkohen në skemë 'snowflake' të organizuar. Për t'iu paraqitur shfrytëzuesit se çka është e mundur, kemi disa shembuj të raporteve që i paraqesin të dhënat. Raporti paraqet mundësitë që mund t'i ketë shfrytëzuesi në një raport. Të dhënat që fillimisht ishin në shtatë baza të të dhënave të ndryshme, kanë mundësi të lidhen në data warehouse. Ashtu siç e paraqet prototipi, mundësia për t'i lidhur të dhënat mund të ndihmojë në situatat kur nevojitet ndonjë raport krahasues ndërmjet departamenteve të ndryshme. Ky është një shembull i thjeshtë i krijimit të data warehouse, por shfaq konceptin e një pasqyre të madhe të implementimit të data warehouse. Data warehouse finale është baza e të dhënave në SQL Server 2012, që përdorë Server Integration Services si vegël për ETL, Server Analysis Services si vegël për krijimin e kubeve dhe për përgatitje të të dhënave për raportim dhe SQL Server Reporting Services si vegël e raportimit.

Tabelat dimenzion do të jenë direkt nga tabelat nga baza e të dhënave, duke i shtuar një dimension ID që është fushë identifikuese dhe rritet për një. Disa nga tabelat dimenzion do të kenë të dhëna edhe nga tabela të tjera, siç janë tabelat lookup. Tabela fakt do të ketë një fakt ID unike që lidhet me tabelat dimenzion. Në këtë shembull të gjitha tabelat fillimisht do të jenë të zbrazëta. Megjithatë, për shkak të qëllimit dhe madhësisë, ky data warehouse nuk do të përfshijë të gjitha detajet e data warehouse, mirëpo ende përcjell dizajnin bazë dhe rezultatet.

3.15 Konstruktimi i ETL

Në figurën e mëposhtme është paraqitur diagrami i bazës së të dhënave të data warehouse.




Figura 7. Diagrami i bazës së të dhënave të data warehouse

3.16 Mbushja e tabelave

Figurat në vazhdim tregojnë mbushjen e tabelave dimension dhe fakt. Së pari do të mbushen tabelat dimension dhe pastaj tabelat fakt. Tabelat fakt mbushen pas tabelave dimension për shkak të lidhjes me çelësat që gjenden në tabelat dimension.

Mbrenda Data Flow do të ndodhin shumë ekstrakte, transformime dhe ngarkime në të njëjtën kohë. Derisa të dhënat ekstrahohen nga shumë tabela, e gjithë puna e ETL mund të bëhet njëkohësisht. Aktivitetet mbrenda një tasku fillojnë me ekstrakt dhe do të zgjedhin tabelën e caktuar në SQL. Nëse është e nevojshme të lidhet me ndonjë tabelë tjetër, mund të përdoret tasku 'lookup' për të marrë të dhëna nga një tabelë tjetër para se të bëhet ngarkimi në tabelën destinuese.

3.16.1 Mbushja e tabelave dimension

Tabela dimension 'AccountCode'

Pyetësi i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

```
SELECT tcc.AccountCode,tcc.AccountDescription_1  
FROM tblCCGLAccountCode tcc
```

Paketa në SSIS për tabelën dimension 'AccountCode'




Figura 8. Control Flow i tabelës dimension 'AccountCode'




Figura 9. Data Flow i tabelës dimension 'AccountCode'

Tabela dimension 'ElDebitors'

Pyetësi i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

```
SELECT de.ElDebtorID, de.AgencyID, de.ConsumerID, de.DisconnectedDebtor,  
de.TariffGroupID, de.AddressID, de.SocialCategoryID, de.AMeterID, CAST  
(de.AMeterConstant AS INT) AS AMeterConstant, de.AMeterDigits,
```

```

de.AMYearOfManufacture, de.RMeterID, CAST(de.RMeterConstant AS INT) as
RMeterConstant, de.RMYearOfManufacture, de.MaxigraphID,
CAST(de.MaxigraphConstant AS INT) AS MaxigraphConstant,
de.MXYearofManufacture, de.InsDate, de.AM_AMR, de.ConsumerCategoryID,
(ISNULL(c.Company + ' ', '') + ISNULL(c.ConsumerFirstName + ' ', '') +
ISNULL(c.ConsumerMidleName + ' ', '') + ISNULL(c.ConsumerSecondName,
'')) AS ConsumerName, c.RegistrationNo,
(ISNULL(LTRIM(RTRIM(s.StreetName)) + ' ', '') +
ISNULL(LTRIM(RTRIM(de.AddressNo)), '')) AS MeterAddress

FROM tblCCEldebtors de left outer join tblCCConsumer c
ON de.ConsumerId=c.ConsumerId

LEFT OUTER JOIN tblCCStreets s ON de.StreetID = s.StreetID

```

Paketa në SSIS për tabelën dimension 'ElDebtors'




Figura 10. Control Flow i tabelës dimension 'ElDebtors'




Figura 11. Data Flow i tabelës dimension 'ElDebitors'

Tabela dimension 'PostGLArchive'

Pyetësi i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

```
SELECT p.ArchiveId, p.JournalId, p.Debit, p.Credit, p.DueDate, p.PostJournalId,
j.JournalTypeId, j.JournalDate, LEFT(p.JournalId, 3) AS AgencyID, j.InsDate
FROM tblPostGLArchiveDetail p INNER JOIN tblPostGL_Journal j
ON p.PostJournalID = j.JournalID
WHERE YEAR(j.JournalDate) > 2016 AND j.JournalTypeId IN
('MC','MB','SR')
```

Paketa në SSIS për tabelën dimension 'PostGLArchive'




Figura 12. Control Flow i tabelës dimension 'PostGLArchive'




Figura 13. Data Flow i tabelës dimension 'PostGLArchive'

Tabela dimension 'Readers'

Pyetësi i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

```
SELECT AgencyId, tc.Reader_DelivererID, CAST (tc.Reader as nvarchar(50))
AS Reader,tc.TS_Code
```

```
FROM tblCCReader tc
```

Paketa në SSIS për tabelën dimension 'Readers'




Figura 14. Control Flow i tabelës dimension 'Readers'




Figura 15. Data Flow i tabelës dimension 'Readers'

3.16.2 Mbushja e tabelave fakt

Tabela fakt 'Invoices'

Pyetësi i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

```
SELECT  tcb.InvInsOrder, tcb.AgencyID, tcb.EIDDebitorID, tcb.ReaderID,
        tcb.BillingPeriodYear, tcb.BillingPeriodID, tcb.SRID, tcb.ActiveHighConsum,
        tcb.ActiveLowConsum, tcb.ReactiveHighConsum, tcb.ReactiveLowConsum,
        tcb.DemandPower, tcb.Demand_Amount, tcb.BillAmount, tcb.NettAmount,
        tcb.VATAmount, tcb.AMeterID, tcb.ActiveHighMR, tcb.ActiveLowMR,
        tcb.TariffGroupID, tcb.BillingDate, tcb.ReadingDate, tcb.TaxFreeDebitor
```

```
FROM tblCCIInvoicesH tcb
```

```
WHERE BillingPeriodYear > 2016
```


Pas mbushjes së tabelës me të dhëna nga baza e të dhënave transaksionale, do të bëhet plotësimi i shënimeve nga tabelat dimension përmes stored procedurave:

exec updateFactInvoicesDebitor – për plotësim nga tabela dimension ‘ElDebitors’

exec updateFactInvoiceReader – për plotësim nga tabela dimension ‘Readers’

Paketa në SSIS për tabelën fakt ‘Invoices’




Figura 16. Control Flow i tabelës fakt 'Invoices'




Figura 17. Data Flow i tabelës fakt 'Invoices'

Tabela fakt ‘HPInvoices’

Pyetëtori i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

```
SELECT th.HPInvoiceID, th.ElDebitorID, th.AgencyID, th.FinalNetAmt,
th.FinalVATAmount, th.FinalInvAmount, th.HPInsDate, th.HPClosed,
th.HPClosedDate, th.InvTotKwh
```

FROM tblHPInvoices tb

WHERE YEAR(tb.HPClosedDate) > 2015

Tabela fakt pastaj do të plotësohet me shënimet nga tabela dimension përmes stored procedurës:

exec updateFactHPInvoicesDebitor – për plotësim nga tabela dimension ‘ElDebitors’

Paketa në SSIS për tabelën fakt ‘HPInvoices’




Figura 18. Control Flow i tabelës fakt 'HPInvoices'




Figura 19. Data Flow i tabelës fakt 'HPInvoices'

Tabela fakt ‘GLArchive’

Pyetësi i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

SELECT 'DPE' AS AgencyID, tc.ArchiveID, tc.AccountCode, tc.Debit,
tc.Credit, tc.ElDebitorID, tc.DocumentDate, tc.DueDate, tc.DocumentNo, tc.JournalID

FROM tblCCGLArchive tc

WHERE YEAR(tc.Documentdate) > 2016

Pas mbushjes së tabelës fakt me shënime, do të plotësohen shënimet nga tabela dimension përmes stored procedurave:

exec updateFactGLArchiveDebitor – për plotësimin e shënimeve nga tabela dimension ‘ElDebitors’

exec updateFactGLArchivePostGL – për plotësimin e shënimeve nga tabela dimension ‘PostGLArchiveDetail’

Paketa në SSIS për tabelën fakt ‘GLArchive’




Figura 20. Control Flow i tabelës fakt 'GLArchive'




Figura 21. Data Flow i tabelës fakt 'GLArchive'

Tabela fakt ‘DOCorrections’

Pyetësi i përdorur për të mbushur këtë tabelë është:

WHERE YEAR(td.ReportRate) > 2015

exec updateFactCorrectionDebitor – për plotësimin e shënimeve nga
tabela dimension 'ElDebitors'

Paketa në SSIS për tabelën fakt 'DOCorrections'




Figura 22. Control Flow i tabelēs fakt 'DOCorrections'




Figura 23. Data Flow i tabelēs fakt 'DOCorrections'

3.17 Konstruktimi i kubeve

Pas procesit të bartjes së të dhënave nga bazat e të dhënave transaksionale përmes ETL, do të vazhdojmë me krijimin e kubeve dhe përgatitjen e të dhënave për fazën e raportimit.

3.17.1 Krijimi i DSV

DSV është abstraksion i një burimi relacional të të dhënave që bëhet bazë e kubeve dhe dimensioneve në projektin multidimensional. Qëllimi i DSV-së është të mundësojë kontrollin mbi strukturën e të dhënave që përdoret në projekt.




Figura 24. Krijimi i DSV

3.17.2 Krijimi i kubit

Pas definimit të DSV, hapi tjetër është definimi i kubit dhe dimensioneve të cilat do të përdoren nga kubi. Në dimensione do t'i bartim të gjitha tabelat dimension të cilat i kemi krijuar përmes SSIS. Kubi do të përmbajë tabelat fakt të krijuara në SSIS.




Figura 25. Krijimi i kubit

Dimenzionet mund të përdoren për një apo më shumë kube. Në figurën e mëposhtme paraqitet lidhja e dimenzioneve me grupet matëse.

DW Cube.cube [Design]				
Measure Groups				
Dimensions	[u] Fact GL Archive	[u] Fact HP Invoices	[u] Fact Do Correction	[u] Fact Invoices
[u] Dim Account Code	Account Code			
[u] Dim Post GL Archive D...	Id Dim Post GL			
[u] Dim Eldebitors	Id Dim Eldebitor	Id Dim Eldebitor	Id Dim Eldebitor	Id Dim Eldebitor
[u] Fact HP Invoices		Id Fact HP		
[u] Fact Do Correction			Id Fact Correction	
[u] Fact Invoices				Id Fact Inv
[u] Dim Reader				Id Reader

Figura 26. Lidhja e dimenzioneve me grupet matëse

3.17.3 Definimi i kalkulimeve

Anëtarët e kalkuluar janë anëtarë të dimenzioneve apo grupeve matëse që janë të definuar bazuar në kombinimin e të dhënave të kubit, operacioneve aritmetike, numrave dhe funksioneve.

Një shembull i një kalkulimi ndërmjet dy elementeve të kubit është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 27. Kalkulimi

3.17.4 Definimi i KPI

Indikatorët kyç të performancës të njohur si KPI standardizojnë paraqitjen e rezultateve. KPI-të mund të shfaqen në raporte, portale, panele, API, etj. Një KPI mund të krijohet nga një apo më shumë grupe matëse.

Së pari caktohen shprehjet e vlerave apo kalkulimet, pastaj shprehja e targetit që synohet, statusi i cili paraqitet grafikisht për të parë më lehtë statusin e shprehjes së vlerave me vlerën e synuar, dhe në fund trendi apo tendenca e cila tregon se vlerat e kalkuluara janë duke u përmirësuar apo duke shkuar më keq në relacion me vlerat e synuara.




Figura 28. Krijimi i KPI

3.17.5 Definimi i aksioneve

Për të rritur performancën e pyetësorëve duhet të definohen aksionet të cilat mundësojnë filtrimin e të dhënave duke caktuar numrin total të rreshtave që kthehen si rezultat. Shembulli i krijimit të një aksioni 'drillthrough' është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 29. Krijimi i aksionit ‘drillthrough’

3.18 Raportet

Tani që ekziston prototipi i data warehouse, pyetja është se çfarë mund të bëjmë me të dhënat për t’i paraqitur përparësitë e data warehouse.

